

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Blofi fëmijëror i vettingut të politikanëve
ADRESA	https://www.balkanweb.com/blofi-femijeror-i-vettingut-te-politikaneve/
BURIMI	balkanweb.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 11:08:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	8 shtator 2018, 06:29:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 8 shtator 2018, 06:28:00 UTC → 8 shtator 2018, 06:30:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1ced4fb096deb95c2ec77df33c90a76d818b84642a6bf9315833a275faf44646
TEKSTI	c8544805fdb34f36cdf96524e45937ca9e127cbe92085f729399e28f8570458f
PAMJA	c773331caaaa9d05b0e66ce9a5fe65f5dc17b3db06fe51032e6601e953de95fe2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	79bbbed3b5badbb2ef0b2ae99c19391a2a95a6b5fc9748ba6b2f430e54f29fbc5
E MËPARSHMJA	15470fde88ab6c2757e3b574ed19d73083d87b54a2e0ff8cbce61e0730f9aef9
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/79bbbed3b5badbb2ef0b2ae99c19391a2a95a6b5fc9748ba6b2f430e54f29fbc5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Balkanweb TV](#)
- [Foto Galeri](#)
- [Emisione](#)
- [Moti](#)
- [Sondazh](#)
- [Shtypi](#)
- [Dossier](#)
- [Shëndeti](#)
- [Gatimi](#)
- [Horoskopi](#)
- [News24](#)
- [Kontakt](#)



-
-
-

- [Fillimi](#)
- [Minutë pas minute](#)
- [Shqipëria](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Rajoni](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Metropol](#)
- [Analiza](#)
- [Teknologji](#)
- [Shëndeti](#)
- [Horoskopi](#)
- [Emisione](#)



Kërko këtu



- [Fillimi](#)
- [Minutë pas minute](#)
- [Shqipëria](#)
 - [-Kronikë](#)
 - [-Politikë](#)
 - [Aktualitet](#)
 - [-Ekonomi](#)
 - [-Sociale](#)
 - [-Kulturë](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Rajoni](#)
 - [-Greqi](#)
 - [-Magedoni](#)
 - [-Serbi](#)
- [Sport](#)
 - [-Bota](#)
 - [-Shqipëri](#)
 - [EURO 2024](#)
- [Bota](#)
 - [USA 2024](#)
 - [Lufta në Ukrainë](#)
- [Kulturë](#)
 - [-Art](#)
 - [-Libra](#)
 - [-Filma](#)
 - [-Muzikë](#)
- [Metropol](#)
 - [-Kuriozitete](#)
 - [-Life-Style](#)
 - [-Personazhe](#)
 - [-Show Bizz](#)
- [Analiza](#)
- [Teknologji](#)
 - [-Auto-Moto](#)
 - [-Pc-Mobile](#)
 - [-Shkence](#)
- [Shëndeti](#)
- [Horoskopi](#)
- [Emisione](#)

[Minute pas minute](#)

- [EKSKLUZIVE! "Ti merru me qeverinë". Ahmetaj zbardh bisedat e Ron Yeffet: Procesin duhet ta bëjmë në mënyrë të heshtur! Mediat ...](#)
- [Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë](#)
- [Arben Ahmetaj: Thonë se Rama nuk merr para, por edhe El Chapon nuk e kapën duke shpërndarë drogë. Nxjerrja e News24 nga godina...](#)
- [VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atletico's, një gol vendos Napoli-Arsenal](#)
- [102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, marshim kilometrik në rrugët e Tiranës](#)


- [Fillimi](#)
- [>](#)
- [Analiza](#)

Blofi fëmijëror i vettingut të politikanëve

[Andi Bushati](#) | 08 Shtator, 2018 08:29



Madhësia e tekstit:

 [Download on Apple Store](#)  [Get it on Google Play](#)

-
-
-
-
-
-

Lulzim Basha ka hedhur në treg një tjetër propozim qesharak, atë për të bërë vetingun e politikanëve të lidhur me krimin. Për këtë, ai ka thënë se do t'i propozojë Kuvendit edhe disa amendamente kushtetuese që deputetët t'i nënshtrohen të njëjtës "gjueti shtrigash", njësoj si prokurorët dhe gjykatësit. Por, ideja e lëshuar papritmas, madje e mbështetur edhe nga kundërshtarë të fortë të tij, nuk është asgjë tjetër më shumë sesa një budallallëk me brirë.

Po t'i besosh sado pak propagandës që bën prej kohësh PD-ja, kjo nismë është thjesht utopike dhe e pa arritshme. Si mund të pretendojë sot një opozitar, i cili këmbëngul se Edi Rama ka kapur tërësisht edhe institucionet e vetingut, që janë në monitorim të fortë ndërkombëtar, të besojë se kjo mazhorancë do të angazhohet kundër vetes së saj?

Si mund të imagjinojë ai, se amendamentet e reja kushtetuese që kërkojnë një shumicë të cilësuar do arrijnë të bëjnë bashkë me votat e demokratëve edhe ato të socialistëve?

Si mund të ëndërrojë ai, edhe nëse kjo ndodh falë ndonjë presioni hipotetik ndërkombëtar, që edhe pasi ta votojnë, socialistët nuk do ta minojnë këtë proces?

Pra, Lulzim Basha duhet të ishte i ndërgjegjshëm se kjo as nuk ka gjasë të ndodhë dhe as mund të kryhet kurrë, për sa kohë Edi Rama është në pushtet.

Po atëherë pse e hedh idenë në treg? Thjesht për të gënjyer publikun, apo se është një naiv i pashërueshëm që beson tek paktet me kundërshtarin?

Kësaj dileme mes Bashës mashtues, apo të papjekur, dikush më dashamirës ndaj tij mund t'i shtonte edhe një të tretë: atë të njeriut që beson tek armët me të cilat politika luhet në Perëndim. Sipas këtij versioni, megjithëse ai është i ndërgjegjshëm se kjo sfidë nuk realizohet, kreu i PD-së nuk këmbëngul kot në të. Ai kërkon ta shndërrojë këtë betejë në një vijë demarkacioni mes së mirës dhe së keqes. Ai e di që socialistët nuk e përballojnë dot këtë sfidë, prandaj e hedh atë në treg për të fituar besimin e publikut, për kredibilitet përpara njerëzve, në fund të fundit, për të treguar se kush është pro krimin dhe kush e lufton atë.

Po në pikën që kanë arritur gjërat në Shqipëri, pyetja që shtrohet është: edhe sikur të jetë kështu, a është efikase kjo rrugë? A mjafton fitorja e betejave të tilla për të ngadhënjyer në luftën finale? Natyrisht që jo. Sepse Basha e ka provuar edhe vetë që kjo gjë nuk funksionon. Në çdo vend normal të globit, një pushtet që do ishte mundur edhe në betejën e dekriminalizimit (me mbi 20 të zgjedhur të nxjerrë nga politika), edhe në betejën e kanabizimit (ku kreu i rendit rezultoi i lidhur me trafikantët), do t'i kishte mbledhur valixhet me kohë.

Por në një arenë si Shqipëria, ku më tepër se votuesit luajnë rol paratë e oligarkëve, të fortit e dalë nga burgu dhe televizionet servise të qeverisë, të fitosh sfida të tilla politike është krejt e padobishme.

Pra në këtë kuptim, ideja e Bashës për vetingun e politikës është totalisht shterpë: e para, se është e paralizueshme dhe mbi të gjitha, sepse tashmë është ezauruar koha për të luftuar me mjete normale politike.

Kjo qeveri nuk mbahet më në këmbë, as se është e besueshme, as se ka simpatinë e njerëzve dhe as se ka mbështetjen e tyre. Ajo qëndron në zyra sepse ka kapur pushtetin financiar, mediatic dhe kriminal. Prandaj me të nuk konkurrohet, as me gjetje ligjore, as me lëvizje shahisti dhe as ngrënie gurësh në damë. Me të janë të pafrytshme lojërat mbi tavolinë. Për të pasur shpresë të fitosh ndaj saj, duhet përmbysur tryeza.

Sa më shpejt Lulzim Basha ta kuptojë këtë, aq më parë do t'u japë fund propozimeve fëmijërore, si ato për vetingun e politikanëve. Sa më vonë që kjo të ndodhë, aq më shumë ai do vazhdojë të jetë fasada false e një regjimi.

Burimi: [Gsh.al](#)

© **BalkanWeb**

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa:

- [analize](#)
- [ANDI BUSHATI](#)
- [vettingu në politikë](#)

Të ngjashme

 [Piro Ahmetaj](#)

[Replikë e imponuar me Presidentin komedian, Zelensky](#)

[Nga Piro Ahmetaj](#) | 11 Gusht, 2026

 [Medlir Mema1](#)

[Basti i rrezikshëm i Qeverisë Rama](#)

[Medlir Mema*](#) | 09 Maj, 2025

loading...

Të Fundit nga Analiza

 [Photo Output](#)

[Kronikat e skemave të dyshimita financiare në Shqipëri](#)

[Redi Ametllari](#) | 09 Shtator, 2026

 [Capture](#)

[“Në Shtetin e Ronit”/ Irena Begiraj: Yeffet qeveris, Rama administron – korrupsion dhe presion për të blerë heshtjen! “Besa”, “Pasqyrat” dhe “Prania Besnike”, manovra për të maskuar degradimin](#)

09 Shtator, 2026

 [Thoma Gellci](#)

[Fillon gjuetia për miliardat e grabitura](#)

[Thoma Gëllçi](#) | 08 Shtator, 2026

 [Photo Output](#)

[“Kinemaja jonë ka urrejtje për qytetin, regjisorët mendojnë si buxhetistë”/ Kritika e Ben Blushit: Pse janë kaq të shëmtuar filmat e rinj shqiptarë](#)

[Ben Blushi](#) | 06 Shtator, 2026

 [Evarist Beqiri](#)

[Sfida e madhe e Shqipërisë pas-Ramës](#)

[Evarist Beqiri](#) | 04 Shtator, 2026

 [Grigels Muçollari](#)

[Rama zbulon fajtorë të rinj për krizën, po askush nuk mashtrohet më!](#)

[Grigels Muçollari](#) | 03 Shtator, 2026

Kategoria Video

 [8ba0772d 6e9a 4844 A19f 8379a19bc9f4](#)

[Mbyllet tubimi i 102. thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë](#)

09 Shtator, 2026

 [Img 0527](#)

[VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin. Liverpool fiton ndaj Atletico, një gol vendos Napoli-Arsenal](#)

09 Shtator, 2026

 [21 Dhjetori1](#)

[102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, marshim kilometrik në rrugët e Tiranës](#)

09 Shtator, 2026

 [21 Dhjetori2](#)

[“Dorëheqje”/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve](#)

09 Shtator, 2026

 [Vasil Shanto1](#)

[“Ju erdhi fundi”/ Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto, thirrje të forta kundër qeverisë: Rama në burg, Balluku në burg](#)

09 Shtator, 2026

 [Marshii Drejtoria](#)

[LIVE- Vijon aksioni qytetar! Protestuesit marshojnë drejt Policisë së Tiranës, kumbojnë thirrjet: Ju erdhi fundi!](#)

09 Shtator, 2026

loading...

 [Balkanweb app](#)  [Download on Apple Store](#)  [Get it on Google Play](#)

Kerko ketu

Lajmet e fundit

-  [8ba0772d 6e9a 4844 A19f 8379a19bc9f4](#)

[Mbyllet tubimi i 102. thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë](#)

09 Shtator, 2026

 [Img 0527](#)

[VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin. Liverpool fiton ndaj Atletico, një gol vendos Napoli-Arsenal](#)

09 Shtator, 2026



[102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, marshim kilometrik në rrugët e Tiranës](#)

09 Shtator, 2026



[“Dorëheqje”/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve](#)

09 Shtator, 2026



[“Ju erdhi fundi”/ Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto, thirrje të forta kundër qeverisë: Rama në burg. Balluku në burg](#)

09 Shtator, 2026




[LIVE- Vijnë aksioni qytetar! Protestuesit marshojnë drejt Policisë së Tiranës, kumbojnë thirrjet: Ju erdhi fundi!](#)

09 Shtator, 2026

Na ndiqni në rrjetet sociale

@balkanweb

-
-
-



Faqet zyrtare

- [News24](#)
- [Gazeta Shqiptare](#)
- [Radio RASH](#)

Kontakt

- [Focus Media News shpk](#)
- [NUIS/NIPT K21909002K](#)
- [Privacy Policy](#)
- [Contact](#)
- [Email: \[email protected\]](#)

Emisione news24

- [Autoktonët](#)
- [Emisioni Vila 24](#)
- [Fit Station](#)
- [Kjo Javë](#)
- [Koha për t'u zgjuar](#)
- [Me zemër të hapur](#)
- [Në shënjestër](#)
- [News24 Fundjavë](#)
- [Opionencë](#)
- [Podcast](#)
- [Sport News](#)
- [Studio 24](#)
- [Tak Fak](#)
- [Vetting](#)

Kategori

- [Fillimi](#)
- [Minutë pas minute](#)
- [Shqipëria](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Rajoni](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Metropol](#)
- [Analiza](#)
- [Teknologji](#)
- [Shëndeti](#)
- [Horoskopi](#)
- [Emisione](#)

Mediat e huaja

- [New York Times](#)
- [Guardian](#)
- [WEB BBC](#)
- [WEB CNN](#)
- [REUTERS](#)
- [Washington Post](#)
- [Times Online](#)
- [Financial Times](#)
- [WEB Yahoo](#)

- [WEB MSN](#)
- [USA Today](#)

© 2026 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

 [logo Twitter](#)  [logo Facebook](#)  [logo Instagram](#)  [logo Youtube](#)
 [scroll to top](#)
 [logo balkanweb](#)

Emisione news24

- [Autoktonët](#)
- [Emisioni Vila 24](#)
- [Fit Station](#)
- [Kjo Javë](#)
- [Koha për t'u zgjuar](#)
- [e zemër të hapur](#)
- [shënjestër](#)
- [News24 Fundjavë](#)
- [Oponencë](#)
- [Podcast](#)
- [Sport News](#)
- [Studio 24](#)



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.